



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
MUNICIPALITY -SUHAREKË

25.03.2019

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVO - MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARRË NE DOREZIM - RECEIVED			
Në lista org. Org. Jednিকা Org. Unit	Numri Broj Number	Prillog Appendix	Vlera Vrednost Value
11	016	14932	2

Datë: 25.03.2019

Në bazë të vendimit 01-Nr-016-14932 të datës 28.02.2019 të Asamblesë Komunale dhe në bazë të procesverbalit nr. 11/2019 të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të datës 25.03.2019 komisioni përkatës shpallë:

KONKURIM TË HAPUR Nr.03/2019

Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri 99 (nëntëdhjet e nëntë) vitet të pronës komunale :

1. Parcela kadastrale:

P-72116046-02785-79, me sipërfaqe të përgjithshme prej 39779m² , sipas certifikatës së pronës nr.2785-79,datës 25.02.2019, zona kadastrale Suharekë,vendi I quajtura "Shiroko" e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal – Suharekë , me destinim sipas planit rregullativ të zonës industrial "Shkollë Bujqësore" , nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen 10967m² për ndërtimin e shkollës profesionale me kuadër të kualifikuar me nivelin e shkallës së 5 (pestë) drejtimi "Mekatronik"

Dëshmitë e kërkuara:

1. Kopja e dokumentit të identifikimit (për personat fizik dhe juridik).
2. Certifikata e regjistrimit të biznesit/OJQ-së (për personat juridik)
3. Dëshmi për kryerjen e obligimeve komunale (për personat fizik tatimi në pronë dhe për personat juridik taksat Komunale).
4. Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK (për personat juridik)
5. Projektet e realizuara per dy vitet e fundit për këtë veprimtari.
6. Garancioni bankar nga banka ose kompanit e sigurimeve të licencuara në Kosovë në 10% të vlerës së investimeve i cili duhet të sillet para nënshkrimit të kontratës.
7. Kompania ose organizata duhet të jetë e licencuar

Kriteret e kërkuara;

- Oferta e kompletuar me dokumentët e kërkuara
 - Oferta ekonomiksht më e favorshme
 - Deklaratë vjetore tatimore nga ATK –ja për 2 (dy) vitet e fundit-**10% të pikëve**
 - Vlera e Investimeve konform deklaratave vjetore për dy vitet e fundit – do të vlerësohet sipas çmimeve të tregut....**20% të pikëve.**
 - Numri i të punësuarve specifiko pozitat e deklaruara të punëtorëve - numri i punëtorëve duhet të jetë në harmoni me vlerën e investimeve**20% të pikëve**
 - Lloji i veprimtarisë adekuate.... **20% të pikëve.**
 - Lloji i veprimtarisë të ngjajshme....**5% të pikëve.**
 - Plani dinamik- jo më shumë se 2 vite....**15% të pikëve.**
 - Projekti Ideor konform Planit Rregullues të hollësishëm Zona Industriale-Shirokë si dhe planit investiv, me :**10% të pikëve.**
- a) Situacioni i ngushtë me përpjesë 1:500 – ku specifikohet objekti, hyrja ne situacion dhe objekt, rrugët, parkingjet, gjelbrimi si dhe çdo informatë shtesë që është e nevojshme. Githashtu të shënohen dimensionet dhe sipërfaqja bruto e shputës së objektit
 - b) Baza e përdhësës me përpjesë 1:100, me organizim të hapësirave,identifikim të hyrje/daljeve, kuota, dimensionim, sipërfaqe, si dhe çdo informatë shtesë që është e nevojshme.

- c) Baza e katit me përpjesë 1:100, me organizim të hapësirave , kuota, dimensionim, sipërfaqe, si dhe çdo informatë shtesë që është e nevojshme.(nëse ka)
 - d) Prerjet e objektit me përpjesë 1:100 – së paku dy prerje karakteristike
 - e) Perspektiva
 - f) Përshkrimi teknik për secilën fazë të punimeve
 - g) Paramasa dhe Parallogaria – sipas çmimeve të tregut dhe të përputhet me projektin Ideor
- Projekti dhe paramasa(sipas çmimeve te tregut) te jene te vertetuara nga kompania projektuese. – te bashkangjitet deklarata e kompanise projektuese qe projekti eshte projektuar sipas kushteve te planit rregullues te hollesishem ZI dhe sipas normave teknike te projektimit

Vërejtje:

- Aplikimi me mungesë të ndonjërit prej dokumenteve do të thotë diskualifikim.
- Veprimtaria joadekuate do të diskualifikohet nga konkurimi.
- OE ka të drejtë të tërhiqet nga aplikimi i hapur jo më vonë se 3 (tre) ditë nga hapja e ofertave.

Afati për tërheqjen e formularit të ofertave është deri më date **28.05.2019**, zyra e prokurimit nr.12 kati 3, Komuna Suharekë.

Afati i dorzimit të ofertave deri më date **28.05.2019** deri në ora 13.30 zyra pritëse nr.1 Komuna Suharekë.

Hapja e ofertave bëhet më **31.05.2019** në ora 14:00 në sallën e bordit në Komunen e Suharekës.

Hapjen dhe vlersimin e ofertave e bënë komisioni perkatës I kuvendit ë Komunës së Suharekës dhe përfituesin e vendos Asambleja Komunale konform ligjit nr.04/L-144.

Informatat shtesë;

Nr. tel: 029 271 708

emrush.bytyci@rks-gov.ne

Kryesuesi i komisionit

Emrush BYTYÇI

